



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT VENDIM

**MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESEM 2024-2026**

Këshilli Bashkiak Berat, pasi u njoh me materialin “Mbi miratimin e tavaneve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, mbështetur në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” , Ligjit nr. 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore ”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7 datë 25.02.2022 “ Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore ”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 6 datë 28.02.2023 “ Për përgatitjen e PBA vendor 2024-2026”,

V E N D O S I :

1. Të miratojë:

1.1 Planin financiar të Bashkisë Berat për periudhën afatmesme 2024-2026 sipas Tabelës 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij p/vendimi.

1.2 Tavanet përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 sipas Tabelave 2 dhe 3 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij p/vendimi.

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe Ekipet e Manaxhimit të Programeve Buxhetore.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2023

MBI SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR BANORËT E BANESAVE SOCIALE .

Kryetari i Bashkisë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma “c”; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, ”Për strehimin social”, vkm nr.522, datë 25.7.2019 “Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë , kur banesat sociale me qira financohen nga buxheti i shtetit ose i bashkive apo nga kombinimi i tyre” dhe Vendimit të Komisionit të Strehimit;

V E N D O S I :

1. Miratimin e subvencionimit të qirasë në vlerën 1,815,632 lekë, për 32 familjet e strehuara në banesat sociale të bashkisë sipas tabelës bashkëlidhur .
1. Periudha e subvencionimit të qirasë fillon me 01.02.2023 ÷ 31.01.2024.
2. Financimi i subvencionit të qirase do të bëhet nga buxheti i bashkisë
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile , Pronave , Transportit dhe Shërbimeve.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE , PRONAVE TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

MBI SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR BANORËT E BANESAVE SOCIALE .

Të nderuar Këshilltare !

Bashkia Berat ka planifikuar në buxhetin e saj për vitin 2023 , fond për subvencionimin e qirasë për familjet me probleme sociale dhe ekonomike , që kanë në përbërjen familjare persona me aftësi të kufizuar,invalidë ,që kanë të ardhurafamiljare mujore shumë të ulta kryesisht me pension dhe me përkrahje sociale, që plotësojnë kriteret e përcaktuara sipas nenit,2 pika 34,42,45 dhe nenit 30 të ligjit nr.22/2018, ”Për strehimin social”.

Nga banorët e strehuar në apartamentet e banesave sociale edhe pse qiraja e tyre është më e vogël se sa vlera e qirasë së banesave në tregun e lirë, gjithmone kemi pasur kërkesa për uljen e masës së qirasë në mënyrë që të përfitonin të gjitha familjet e strehuara,por një veprim të tillë ne e kemi të pabazuar nga ana ligjore ,pasi mbështetur në pikën 2 të nenin 30 “Përcaktimi i qirasë “, vkm-së nr. 522, datë 25.7.2019 “Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë, kur banesat sociale me qira financohen nga Buxheti i Shtetit ose buxheti i bashkive apo nga kombinimi i të dyjave “, ne nuk mund të bëjmë uljen e qirasë

Bashkia Berat duke filluar nga viti 2014, paguan çdo vit këstin e kredisë nga banka e Këshillit te Europës (CEB-i) ku bashkia ka detyrim të shlyeje principalin e kredise , ndersa Qeveria interesat e saj.Deri tani kemi shlyer vlerën e kredisë në shumën prej 531,967.4 € dhe na mbetet për të shlyer deri ne vitin 2026 shuma prej 55,741€.

Bashkia nuk e ka rritur qirane e llogaritur sipas vkm nr. 522, datë 25.7.2019 e cila është për apartamentet 1+1 është 6,994 lekë/muaj dhe për garsoniere , qiraja është 5,225 lekë/muaj. Për fillimin e procedurën së subvencionimit të qirasë, bashkia ka njoftuar të gjitha familjet duke mos përjashtuar asnjë për të sjellë dokumentacionin e plotë të të ardhurave familjare mujore bazë,për llogaritjen e masës së subvencionimit të qirasë .

Komisioni i Strehimit i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë , pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar në bashki , nga banorët e strehuar në banesat sociale konkludoi si më poshtë :

Nga 49 familje të strehuara në apartamentet e banesave sociale, perfitojnë subvencionim te qirase 32 familje ndersa 17 familje nuk e perfitojnë .

Kërkojme nga ana Juaj miratimin e listës së familjeve të përbërë nga 32 familje që u kualifikuan nga Komisioni i Strehimit .

Bashkelidhur lista e perfituesve dhe masa e subvencionimit e llogaritur për çdo familje .

Drejtori
Erlin Kuçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

Nr. _____ prot.

Berat , më ____ . ____ . 2023

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

**Z. Ervin Ceca
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT**

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin shoqërues “ Mbi subvencionimit e qirasë për banorët e strehuar në banesat sociale ”.

**KRYETARI
Ervin DEMO**

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Rovena Shehu : Drejtore e Drejtorisë së Financë-Buxhetit

Erlin Kuçi: Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes Civile , Pronave , Transportit dhe Shërbimeve

Konceptoi:

Meleqe Spahiu, Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit në Drejtorinë e Mbrojtjes Civile ,Pronave Transportit dhe Shërbimeve

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK
PROJEKTVENDIM**

Nr. _____, datë _____ 2023

“ MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z.PERLLUMB DERVISHI DHE FAMILJEN E Z. ELIO ZANI BANESA E TË CILIEVE ESHTË DËMTUAR NGA ZJARRI, NGA BUXHETI I BASHKISE DHE BUXHETI I VITIT 2023 NË MINISTRINË E MBROJTJES , PROGRAMI “ EMERGJENCAT CIVILE “

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 8756, date 26.03.2001 “ Per Emergjencat Civile “ i ndryshuar dhe VKM nr. 329 date 16.05.2012 “Per kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmes shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore “VKM Nr. 414 dt 08/07/2021, “Per miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtezuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”: me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Berat për mbështetje financiare të shtetasve Pellumb Dervishi e Elion Zani për dëmtimin e banesës nga zjarri i rënë në datat 29.01.2023.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Berat.
3. T’i akordojë si ndihmë emergjente nga buxheti i Bashkisë Berat, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2023, familjeve të shtetasve :
 - Pellumb Dervishi në vlerën **206664** (dyqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e kater) leke .
 - Elion Zani në vlerën **92544** (nentëdhjet e dy mijë e pesëqind e dyzet e kater) leke
4. Ndihma financiare për familjet e shtetasve Pellumb Dervishi e Elion Zani përcaktohet sipas kriterëve të VKM nr. 329, datë 16.05.2012.
5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për t’i ardhur në ndihmë familjeve të shtetasve Pellumb Dervishi e Elion Zani banesat e të cilëve janë dëmtuar nga rënia e zjarrit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria Mbrojtjes Civile Pronave Transportit dhe Sherbimeve.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2023

MBI MIRATIMIN E TRANSFERIMIT NË PRONËSI TË BASHKISË BERAT TË PASURISË SHTETËRORE ME NR.907 , PASURIE , ZONA KADASTRALE 3195 ,QË DO TË PËRDORET SI ZYRE INFORMACIONI TURISTIK PËR ZONËN ROSHNIK DHE VEND EKSPOZIMI PËR HISTORINË DHE RESURSET E ZONËS. (INFO POINT ALPIN ROSHNIK)

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore “, neni,9 pika 1.2, gërma “c” neni 54, “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak gërma “e” ,neni 15 të ligjit nr.8743,datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

1. Të miratoj transferimin në pronësi të Bashkisë Berat të pasurisë shtetërore me nr.907 pasurie, Zona Kadastrale 3195, që do të përdoret si zyre informacioni turistik për zonën Roshnik dhe vend ekspozimi për historinë dhe resurset e zonës. (Info Point Alpin Roshnik) .
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve ,Drejtoria e Emergjencave Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore “, i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

Nr. _____ prot.

Berat , më ____ . ____ . 2023

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

**Z. Ervin Ceca
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT**

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues, ” Mbi miratimin e transferimit në pronësi të Bashkisë Berat të pasurisë shtetërore me nr.907 pasurie, Zona Kadastrale 3195, që do të përdoret si zyre informacioni turistik për zonën Roshnik dhe vend ekspozimi për historinë dhe resurset e zonës. (Info Point Alpin Roshnik) .

**K R Y E T A R I
Ervin DEMO**

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Erlin Kuçi : Drejtor i Mbrojtjes Civile, Pronave,Transportit dhe Shërbimeve

Konceptoi:

Luçjano Bojaxhiu , Drejtor i Komanduar i Drejtorisë së Planifikimit Urban ,Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve

Etleva Dhima,Drejtoe e Integritimit European dhe Projekteve

Meleqe Spahiu :Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit e Pronave dhe Strehimit

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1



Adresa: Blvd. "Republika", Berat 5001. Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935, website: www.bashkiaberat.gov.al, Email :
bashkiaberat@yahoo.com

Adresa: Blvd. "Republika", Berat 5001. Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935 Website: www.bashkiaberat.gov.al, Email :
bashkiaberat@yahoo.com